

## AKT THEMELIMI I SHOQËRISË TREGTARE

### **THEMELUES:**

Unë e nënshkruara **Anxhela Daja**, atësia Zenel, amësia Flutura, shtetase Shqiptare, lindur në TIRANË dhe banuesë në TIRANË, me adresë Rruga "Kostaq Cipo", Nd. 4, H.3 Ap. 29, lindur më 04/07/1995, gjendja civile beqare, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me Leternjoftimi ID nr. 038791782 dhe nr. personal J55704076B.

*Me dëshirën dhe vullnet të lirë e të plotë, në mbështetje të neneve 39-53 të Ligjit nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar dhe të ligjit nr. 8788, datë 07/05/2001 redaktoj Aktit të Themelimit si më poshtë vijon;*

### **NENI 1** **STATUSI JURIDIK**

Shoqëria Tregtare është formuar si Shoqëri tregtare sipas ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, (në vazhdim referuar si "Shoqëria").

Shoqëria është Person Juridik Privat Shqiptar.

Ajo ka formën e një Shoqërie me Përgjegjësi të Kufizuar.

### **NENI 2** **EMRI I SHOQËRISË, VULA, THEMELUESIT**

Shoqëria do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin "**Medical Consulting Albania**" Sh.p.k. Qendra ka vulën dhe logon e saj identifikuase, të cilat do të figurojnë në çdo dokument zyrtar të lëshuar prej saj.

Themeluese e Qendrës si dhe ortake e vetme është:

**Znj. Anxhela Daja**, atësia Zenel, amësia Flutura, shtetas Shqiptare, lindur në TIRANË dhe banuesë në TIRANË, më 04.07.1995, adresë Rruga "Kostaq Cipo", Nd. 4, H.3 Ap. 29, gjendja civile "beqare", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me Leternjoftimi nr. 038791782 dhe nr. personal J55704076B.

### **NENI 3** **OBJEKTI I VEPRIMTARISË**

Objekti i Veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë, por duke mos u kufizuar në:

- Ngritura dhe menaxhimi i klinikave private.
- Ndërmarrja e nismave, veprimeve, aktivitetave të ndryshme ligjore që kanë për objekt pjesëmarrjen në procese dhe iniciativa të ndryshme koncesionare, privatizimi apo tenderimi.
- Import-eksport dhe tregtim me shumicë dhe pakicë të instrumentave dhe pajisjeve shëndetësore dhe medicinale, sanitare, shtesa ushqimore dhe dietike. Import, eksport, tregtimi me shumicë, montim dhe riparim i aparaturave dhe pajisjeve mjekësore, implantave si dhe aksesorëve të tyre edhe gjeneratorëve me Reze X, instalimi dhe mirëmbajtjen e të gjithë pajisjeve të cituara më sipër. Investime, shërbime, projekte në fushën e mjeksisë dhe shëndetit;
- Për kryerjen e aktivitetit të saj shoqeria mund të hapë degë të saj brenda dhe jashtë vendit, zyra të reja, njësi përpunimi, shërbim tregëtimi dhe të bashkëpunojë me subjekte të ndryshëm vendas dhe të huaj.
- Tregeti të konsumablave medicinale.



- Dhënie me qera të pajisjeve, mjeksore laboratorike.
- Veprimtari me burime të rrezatimeve jonizuese.
- Të zhvillojë kurse të formimit profesional për mbarëvajtjen dhe specializimin e punonjësve nga ana estetike, profesionale, teknike.
- Kryerja e shërbimeve të marketingut, reklamave, marrëdhënieve me publikun, organizimin e eveneteve, prodhimin apo editimin e reklamave për media;
- Planifikimi i reklamave në media si dhe blerja e hapësirës për këto reklama, krijimi dhe menaxhimi i fushatave dixhitale, monitorimi i mediave, përgatitja apo manaxhimi i faqeve të internetit dhe të mediave sociale, prodhimi i materialeve publicitare, organizimi i fushatave publicitare apo të promocionit, konsulenca në fushën e marketingut dhe mediave, organizimi i aktiviteteve me temë të ndryshme.
- Komisioner, Ndërmjetës, Agjent Shitje.
- Pjesëmarrja në shoqëri ekzistuese ose që do të krijohen në të ardhmen, me qëllim krijimin e subjekteve ligjore, me qëllime të njëjta apo të ngashme.
- Përfaqësimin e shoqërive të ndryshme, shqiptare dhe të huaja, që kanë objekt të njëjtë apo të përafërt me atë të kësaj shoqërie. Shoqëria mund të kryejë aktivitete të tjera të lidhura ose plotësuese me ato të parat dhe çdo aktivitet tjetër të nevojshëm ose të dobishëm për qëllimin e shoqërisë. Shoqëria ka të drejtë të ushtrojë çdo lloj aktiviteti të parashikuar nga ligji në përputhje me rregullat e dispozitat në fuqi. Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në bazë të autorizimeve dhe/ose lejeve dhe/ose licencave përkatëse të lëshuara nga organet kompetente të fushës.

#### **NENI 4** **SELIA E SHOQËRISË**

Selia e Shoqërisë ndodhet në qytetin e Tiranës në adresën: Rruga Peti, pallati 1, kati i parë, dhoma 1 / 4,5,6, nr. i pasurise 151/57-N1, Zona Kadastrale 3266, Sauk, 1001

#### **NENI 5** **KAPITALI I SHOQËRISË**

Kapitali i shoqërisë është në vlerën 100 (njëqind) lekë, i ndarë në 1 (një) kuotë me vlerë nominale të një kuote prej 100 (njëqind) lekë.

**Znj. Anxhela Daja** zotëron 1 (një) kuotë të kapitalit themeltar, pra 100 % të tij në vlerën 100 (njëqind) lekë.

Kapitali themeltar është investuar nga ortaku i vetëm themelues në total.

#### **NENI 6** **KOHËZGJATJA E SHOQËRISË**

Afati kohor i zhvillimit të aktivitetit është i pakufizuar dhe fillon me regjistrimin e Shoqërisë në Regjistrin e Biznesit. Ortakët e Shoqërisë mund të vendosin kufizimin e afatit të veprimtarisë dhe më pas zgjatjen e saj një apo disa herë, sipas një vendimi të posaçëm.

**NENI 7**  
**ORGANET DREJTUESE**

Bazuar në dispozitat e ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve — organi më i lartë vendimmarrës;
2. Administratorët — organi ekzekutiv dhe administrativ i Shoqërisë.

Mënyra e organizimit dhe funksionimit të tyre është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë. Shoqëria do të administrohet nga Administratorët të cilët mund te zgjidhen për një afat deri në pesë vjet me të drejtë rizgjedhjeje.

Administratori i Shoqërisë “Medical Consulting Albania” Sh.p.k., është **Znj. Anxhela Daja**, shtetase shqiptare, e datëlindjes 04.07.1955, lindur në Tiranë dhe banuese në Tiranë, në adresën Rruga ‘‘Kostaq Cipo’’, Nd. 4, H.3 Ap. 29, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar nga karta e identitetit me nr. 038791782 dhe nr. personal J55704076B, e cile zgjidhet për një periudhë 3 vjeçare me të drejtë ripërtëritje.

Shoqëria do të përfaqësohet përpara çdo organi administrativ, gjyqësor, apo çdo entiteti tjetër publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga Administratori i shoqërisë, e cila ushtron të drejtat e saj në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe me legjislacionin shqiptar në fuqi.

**NENI 8**  
**LIGJI I APLIKUESHËM**

Veprimtaria e Shoqërisë rregullohet nga rregullat e Statutit të firmosur nga Ortakët Themelues sipas parashikimeve të ligjit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

**NENI 9**  
**ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**

Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis ortakëve apo midis ortakëve dhe Shoqërisë dhe që mund të kenë si objekt të drejta si rrjedhim i raporteve të tyre me Shoqërinë, do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**THEMELUES:**

**Anxhela DAJA**

